



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT
K R Y E T A R I**

Nr.733/11 Prot

Tiranë, më 19/12/2016

V E N D I M

Nr. 151, Datë 19/12/2016

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË BASHKINË DIBËR "MBI AUDITIMIN E
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Dibër, për periudhën 01.07.2014 deri më 31.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASAT ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nuk njihen plotësisht dhe nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" për 5 komponentët, *konkretisht:*

-Mjedisi i kontrollit. Nuk është miratuar Kodi i Etikës në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr.10296 datë 8.7.2010. Për shkak të strukturimeve, përvoja e punonjësve drejtues është e ulët, 39% e tyre janë me përvojë pune më pak se 1 vit.

-Menaxhimi i riskut. Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010,

është caktuar koordinatorë e riskut por nuk janë evidentuar risqet dhe nuk janë marrë masat për menaxhimin e tij.

-Veprimtaritë e kontrollit. Titullari i njësisë, nuk ka miratuar veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm.

-Edhe për informacionin dhe komunikimin nuk janë miratuar procedura dhe rregulla të shkruara por veprohet bazuar në hierarkinë administrative sipas strukturës organizative të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë.

Lidhur me aktivitetet menaxheriale të strukturave të bashkisë, **nuk janë përcaktuar gjurmët e auditimit** të veprimtarive, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010, neni 4 pika 19.

Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, nuk janë miratuar gjurmët për auditimin.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për të realizuar njohjen e ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga të gjithë punonjësit e saj përmes trajnimeve dhe të punojë për implementimin e kërkesave kryesore që burojnë nga ky ligj në drejtim të mirëmenaxhimit të aktivitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me vendime të Këshillit të Ministrave, janë miratuar në pronësi të Bashkisë Dibër, **pyje dhe kullota gjithsej 30.637 ha.** Këto sipërfaqe shtrihen në 12 Njësi Administrative të Bashkisë Dibër. Sektori i Pronave dhe Strehimit, nuk disponon të dhëna të mjaftueshme mbi administrimin e këtyre pronave:

-Nuk ka të dhëna mbi regjistrimin e pyjeve dhe kullotave në ZVRPP nga ish Njësitë e Qeverisjes Vendore sot Njësi Administrative të Bashkisë Dibër.

-Nuk disponon të dhëna mbi kontratat e lidhura nga ish Njësitë e Qeverisjes Vendore për dhënien me qera të pyjeve dhe kullotave dhe arkëtimin e detyrimeve kontaktuale.

-Nuk disponohen të dhëna mbi gjendjen e statusit juridik të pronave, nëse janë të dëmtuara, nëse pronat janë marrë në dorëzim nga ish Njësitë e Qeverisjes Vendore, me procesverbal të shoqëruara me hartat treguese sipas kërkesave ligjore etj.

Në lidhje me administrimin e pyjeve dhe kullotave, konstatohet mungesa:

-Planeve të mbarështimit të pyllit komunal dhe plani vjetor i shfrytëzimit të miratuara nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore,

-Fondeve përkatëse të miratuara në Buxhetin e Bashkisë për qëllime investimi në mirë administrimin e pyjeve dhe kullotave.

Mangësitë janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2 dhe neni 27 pika 5, Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, kap. III, pika 20, 21, 22, 30 dhe pika 35/a dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, pika 1, ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar neni 4, 5, 26, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal” pikat 4/d, 5 dhe 11, VKM nr. 396, datë 21.06.2006 “Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pikat 4, 5 si dhe ligjin nr. 49/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar, neni 14 pika 5.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat e nevojshme për evidentimin e saktë dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave në zbatim të kërkesave ligjore.

Të administrojë dhe vlerësojë dokumentacionin tekniko ligjor nga ish Komunitat sot Njësi Administrative dhe me komisione të specializuara, të vlerësojë statusin juridik të pyjeve dhe kullotave që me VKM janë miratuar në pronësi të ish Komunitave sot Njësi Administrative. Të hartojë planet e mbarështrimit të pyllit komunal dhe planin vjetor të shfrytëzimit duke miratuar edhe fondet financiare të nevojshme.

Brenda Muajit Shkurt 2017

3. Gjetje nga auditimi: Me VKM nr. 1533, datë 19.11.2008, janë miratuar në pronësi të Bashkisë Peshkopi, prona të pa luajtshme; objekte ndërtimore sheshe dhe troje etj, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës; administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, funeral, zhvillim ekonomik etj.

Për këto prona, nuk është aplikuar në ZVRPP Dibër për të realizuar regjistrim e tyre në pronësi të Bashkisë Dibër, në kundërshtim me ligjin nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2 dhe neni 27 pika 5, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, kap. III, pika 20, 21, 22, 30. Nga Bashkia Dibër, nuk ka bërë inventarizimin e tyre në vite dhe nuk dihet statusi juridik aktualë i tyre.

Nga inventarizimi fillestar i kryer në vitin 2008 **në 230 raste**, është konstatuar statusi juridik me përcaktimet si: “nuk gjendet në hartë”, “e ka në përdorim: (emri i personit)”, “zënë forcërisht” ose “tjetërsuar”, “shitur”, “privatizuar”, “e ka marrë pronari”, “nuk ekziston” etj. Në total, sipërfaqet e zëna janë truall i lirë prej 194,662 m² dhe sipërfaqe ndërtimore dhe truall nën të prej 6,650 m².

Duke llogaritur qiranë për ndërtesat dhe trojet funksionale për periudhën objekt auditimi sipas VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kap. III, pika 2, ***llogariten të ardhura të munguara në shumën 480,076,800 lekë.***

Ndërkohë, konstatohet se nuk është vepruar nga strukturat kompetente të Bashkisë Dibër, për posedimin e pronave e asete të zëna forcërisht dhe për vënien e tyre në përdorim nga bashkia.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për verifikimin në teren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me VKM nr.1533, datë 19.11.2008 dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

a. në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara në shumën 480,076,800 lekë.

b. në rast se nuk arrihet marrëveshje me personat përkatës, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, Policinë Bashkiake për lirimin e aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

Brenda Muajit Mars 2017

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, nga Bashkia Dibër, janë dhënë **41 leje shfrytëzimi** për të cilat u konstatuan shkelje procedurale si vijon:

Në regjistrin e territorit, nuk janë hedhur (pasqyruar) të dhënat e nevojshme në regjistrin e territorit, e për rrjedhojë aktet administrative janë të pavlefshme, veprim në papajtueshmëri me nenin 54, 55 e 56, të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

Në dosje nuk ndodhet kërkesa për leje shfrytëzimi e paraqitur nga investitori i objektit, veprime në papajtueshmëri me nenin 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Në dosje nuk ndodhet deklarata e përputhshmërisë që konfirmon kryerjen e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 neni 42, të ligjit nr.107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Në shumicën e rasteve, mungojnë licencat të autorëve të projektimit të objekteve ndërtimore ose të shtesave të objektit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Të gjitha dosjet e lejeve të shfrytëzimit, janë të pa inventarizuara por edhe në rastet kur kanë inventar, ai është i pa firmosur nga personi që i ka inventarizuar ato, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

4.1. Rekomandimi: Nga Zyra e Urbanistikës, të merren masat dhe të plotësohen dosjet e lejeve të shfrytëzimit me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor.

Të kryhet i inventarizimi i tyre dhe të përditësohet regjistri i territorit me të dhënat e nevojshme sipas kërkesave ligjore.

Brenda Muajt Mars 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Dibër, në vitet 2015-2016, janë miratuar 8 leje zhvillimore ndërtimi. Në mungesë të Planit të Përgjithshëm Vendor, miratimi i këtyre lejeve, është konfirmuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Dokumentacioni që ndodhet në dosjet e këtyre lejeve të ndërtimit, është i pa inventarizuar, praktikë kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

5.1.Rekomandimi: Nga Zyra e Urbanistikës, të merren masat dhe të inventarizohen Dosjet e lejeve të zhvillimit dhe plotësohen dosjet ato me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor përfshi lejen zhvillimore me objekt: “*Ndërtim i Ujësjetës*” për dokumentacionin e sipërcituar.

Brenda Muajt Mars 2017

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Dibër, është krijuar dhe funksionon struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes të Territorit Vendor (IMTV) e përbërë nga Kryeinspektori dhe 4 inspektorë.

Në këtë strukturë, emërimi i Kryeinspektorit z. **K.S.** dhe specialisti, z. **B.B.** janë të diplomuar për ekonomi, nuk plotësojnë kriteret ligjore të profesionit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar”, neni 11.

Nga IMTV e Bashkisë Dibër, në vitin 2016, janë dokumentuar 4 raste të ndërtimeve pa leje për të cilat është aplikuar masa e gjobës në vlerën totale 650,000 lekë të cilat nuk janë arkëtuar.

IMTV e Bashkisë Dibër, nuk disponon të dhëna nga ish- Komunitat sot Njësia Administrative e saj, mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimeve pa leje.

IMTV e Bashkisë Dibër, nuk ka programuar dhe ushtruar kontrolle mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimeve pa leje për gjithë hapësirën në juridiksionin e saj, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar, ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

6.1. Rekomandimi: Nga IMTV e Bashkisë Dibër, të merren masat e nevojshme dhe të organizohet puna me programe vjetore e mujore të miratuara nga Kryetari i bashkisë, për

Kontrollin e Territorit në gjithë juridiksionin e vet, përfshi Njësitë Administrative, në zbatim të kërkesave ligjore.

Të procedohet sipas kërkesave ligjore, me prishjen e ndërtimeve pa leje të konstatuara dhe arkëtimin e vlerës së gjobës.

Të riorganizohet struktura e IMTV me personel të kualifikuar sipas kërkesave ligjore.

Brenda Muajt Mars 2017

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015, nuk janë paguar detyrimet (për taksat lokale) nga 70 biznese nga të cilat 3 biznese të mëdha, situatë që përkeqësohet për 6-mujorin e parë të vitit 2016, me detyrime të 392 bizneseve nga të cilat 27 biznese të mëdha.

Performancë e ulët konstatohet në vjeljen e taksë mbi tokën bujqësore. Për vitin 2015, kanë paguar këtë detyrim 22% e familjeve dhe për vitin 2016, e kanë paguar 41% e familjeve. Zyra e Tatim Taksave, nuk disponon regjistra për taksën mbi tokën bujqësore dhe për taksën e ndërtesës.

Për vitin 2015 dhe 2016, totali i borxhit të bizneseve dhe për taksat familjare ndaj Bashkisë Dibër, është në shumën **14,043,200 lekë**, nga të cilat 10,270,000 lekë i përkasin taksave familjare pa taksën për tokën bujqësore.

Nga Bashkia, nuk janë aplikuar masat shtrënguese, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; nenit 90 të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikës 90 të Udhëzimit të MF nr.24 datë 02.9.2008 “Për Procedurat Tatimore te Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

7.1.Rekomandimi: Nga Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Dibër, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore **dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për biznese debitorë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a) **Tu dërgohen Bankave** urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b) **Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale** të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore në R.SH “ të ndryshuar.

c) **Për subjektet të cilët** nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar me ligjin nr.164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d) **Nga ana e Drejtorisë së Financës Bashkia Dibër, të listohen** në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës të tokës nga fermerët dhe taksën e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë (të Bashkisë Dibër përfshi 15 Njësitë Administrative), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimit me anë të Zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj.

Brenda Muajt Mars 2017

8. Gjetje nga auditimi: [REDAKTUAR] sh.a Dibër, nuk është caktuar si agjent tatimor, për arkëtimin dhe mbledhjen e disa taksave dhe tarifave nga popullata së bashku me faturat e ujit të pijshëm, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 5 shkronja (i) të ligjit

nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

8.1 Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa që për mbledhjen e arkëtimit e taksave dhe tarifave nga popullata, të caktojë si agjent tatimor [REDAKTUAR] sh.a Dibër dhe për realizimin e saj të përgatitet aktmarrëveshja e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak, si dhe të kryejë rakordimet periodike mujore/tremujore/vjetore.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan përkatësisht për objektet: “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Erebarë”, “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Bllate e Poshtme dhe Bllate e Epër”, “Punime Sistemimi Asfaltimi Rrugë të Brendshme, Trotuare”, “Ndërtim i Katër Terreneve Sportive Pranë Shkollave Nëntë Vjeçare “Demir Gashi”, “Selim Alliu”, “Seit Najdeni”, “Nazmi Rushiti” dhe “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Radomirë dhe Ndërtim Palestër”, rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015, Bashkia Dibër, ka përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara ku janë përfshirë llogaritë dhe treguesit financiarë të 14 ish -Komunave; Tomin, Melan, Arras, Kastriot, Kala Dodës, Lurë, Sillovë, Luzni, Zall Dardhë, Zall Reç, Maqellarë, Selishtë, Fushë Çidhen, Muhurr sot Njësi Administrative të Bashkisë.

U konstatua se llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “Shpenzime për studime ose kërkime”, është për vlerën 41,979,533 lekë nga të cilat 1,124,030 lekë i përkasëin llogarisë 230 “Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrueshme patrupëzuara”.

Kjo llogari, në analizë të saj, ka të evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime, projektimi dhe oponenca teknike të kryera në vite. Për këto aktive, nuk janë hapur kartela inventariale për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte. **Mungesa e kartelave inventariale**, për sa janë regjistruar në debi të kësaj llogarie studime dhe projekte, është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73.

10.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat për inventarizimin e dokumentacioni teknik si projekte, preventiva dhe studime të kryera në vite në ish-Bashkinë Peshkopi dhe në ish-Komunat, sot Njësitë Administrative duke bërë dhe sistemin në objekteve të cilave iu përkasin.

Në vijueshmëri

11. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e pasqyrave financiare, konstatohet se gjendja e debitorëve në Bashkinë Dibër sipas pasqyrave financiare të datës 31.12.2015, është në vlerën totale **26,066,958 lekë**, të evidentuara përkatësisht në llogarinë 468 “Debitor të ndryshme” për vlerën 7,711,738 lekë dhe në llogarinë 418 “Klientë të ardhura të pafaturuara” për vlerën 18,355,220 lekë. Gjendja e debitorëve i përkasin periudhave të viteve 2010-2015.

Bashkia Dibër, nuk ka marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimit e detyrimeve debitorë në kundërshtim me kërkesat ligjore.

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe e Zhvillimit në Bashkinë Dibër, të marrë masa, të analizojë debitorët dhe të ndërmarr iniciativat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët, me qëllim për të rritur aftësinë pagese dhe të risë burimet financiare të saj.

Në vazhdimësi

12-Gjetje nga auditimi. Për vitin 2015, nga ish-Komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Dibër, gjatë mbylljes së bilanceve në muajin Korrik 2015, nuk kanë bërë inventarizimin e aseteve të tyre. Po kështu Bashkia Dibër, për fund vitin 2015, nuk ka bërë inventarizimin e aseteve për të gjitha Njësitë Administrative, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa për evidentimin e pasaktësive dhe të analizojnë gjendjet e akumuluar në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, për të cilat nuk ka informacion se çfarë përfaqësojnë. Të bëhen sistemimet e nevojshme kontabël ku është mundshme, si dhe të shihet mundësia e vlerësimit dhe rivlerësimit të aktiveve për të cilat nuk ka informacion kontabël.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2016

13. Gjetje nga auditimi: Nga 36 dosje të procedurave të prokurimit që i përkasin periudhës 2014-Qershor 2016, u audituan 5 procedura prokurimit të cilat rezultuan se janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara, në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për sistemin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimit dhe arkivimit të tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

Brenda Muajit Janar 2017.

14.Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit për blerje të ushqimeve për nevojat e çerdheve, kopshteve dhe konviktit në vitin 2015, u konstatua se llogaritja e fondit limit, nuk është bërë sipas kërkesave ligjore bazuar në numurin e fëmijëve që do ushqehen, normativës së ushqime për fëmijë, analizën e çmimit për çdo racion etj.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat dhe të përcaktojë nevojat për blerje ushqimesh, duke siguruar nga strukturat përkatëse të dhënat e nevojshme për numrin e fëmijëve që do ushqehen, llojet e ushqimeve që kërkohen për të plotësuar nevojat e fëmijëve, analiza e çmimit për kuotën e ushqimeve, grafikun e furnizimit me ushqime, përbërjen dhe cilësinë e ushqimeve etj.

Në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i ofertave në faqen elektronike, konstatohet se nuk janë shoqëruar me nënshkrimi elektronik, sipas standardeve ndërkombëtare; kjo përben shkelje të gemës b, pika 1 të nenit 36 Rregullat e zbatueshme të komunikimeve elektronike të LPP ku shprehet se: ofertat elektronike duhet të shoqërohen nga nënshkrimi elektronik, sipas standardeve ndërkombëtare.

15.1.Rekomandimi: Anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe KVO, trajtohen jo me pak se dy herë në vit, anëtarët e tyre të jenë persona të kualifikuar dhe me aftësi profesionale të përshtatshme sipas llojeve të tendereve.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër, në hartimin dhe miratimin e buxhetit nuk ka përfshirë detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve në vlerën **97,673 mijë** lekë për 18 vendime gjyqësore, nga të cilët 93,273 mijë lekë për situacione punimesh dhe 4,100 mijë lekë për paga punonjësish. Shuma e mësipërme i përkasin periudhës të viteve 2006, 2011, 2012 dhe nuk janë kontabilizuar.

Mos kontabilizimi i detyrimeve, është në kundërshtim me Kreun II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve” të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Lidhur me këto detyrime, Bashkia Dibër, nuk ka analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë, në kundërshtim me Udhëzimin nr.2, datë 18.08.2011 dhe nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të thesarit”, si dhe pikën 62 dhe 102, të Udhëzimit MF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

16.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të analizojë gjendjen, të nxjerrë përgjegjësinë dhe të përfshijë në buxhetin e vitit të ardhshëm detyrimet për vendimet Gjyqësore. Bashkia Dibër, të marrë masat për programimin e një buxheti sa më real dhe për ndjekjen e zbatimit të tij në ecuri duke respektuar dispozitat ligjore.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Dibër, është organizuar dhe funksionon struktura e Policisë Bashkiake, në përbërjen e së cilës janë kryeinspektori dhe 12 punonjës policie.

Punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë me formim policor, nuk janë marrë në punë me komision të ngritur sipas kërkesave ligjore si dhe nuk janë pajisur me uniformën e policisë bashkiake. Aktiviteti i policisë bashkiake, nuk është i dokumentuar me programe pune vjetore e mujore si dhe me urdhra të miratuara nga titullari i bashkisë. Praktikë kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake" i ndryshuar, neni 4 dhe Rregulloren e Brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake dhe Komunës miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendore dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”, pika 11.

17.1. Rekomandimi: Të merren masa që të riorganizohet struktura e Policisë Bashkiake, me personel të kualifikuar, të programohet dhe monitorohet aktiviteti i saj me programe dhe detyra të qarta të urdhëruara nga Titullari i Bashkisë e Këshilli Bashkiak. Të merren masa, të pajisen punonjësit e policisë me uniformë sipas kërkesave ligjore.

Brenda Muajt

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 950/7, datë 18.12.2014, Kryetari i Bashkisë Dibër, ka nxjerrë urdhërin nr. 9, datë 14.01.2015 “Për vendosje masash të karakterit organizativ, për shpërblim dëmi dhe masa administrative”.

Nga **9 masa organizative** të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 1 masë, zbatuar pjesërisht 1 masë dhe janë pa zbatuar 7 masa organizative, pa arkëtuar vlera e taksës nga bizneset në shumën 6,541 mijë lekë.

Nga **7 masa të rekomanduara për shpërblimin e dëmit në shumën 6,838,977 lekë** nga 277 subjekte dhe persona fizikë, është zbatuar plotësisht 1 rekomandim, pjesërisht janë zbatuar 3 rekomandime dhe janë pa zbatuar 3 rekomandime. Në total është arkëtuar shuma 869,342 lekë nga 41 subjekte, ngelet pa arkëtuar shuma 5,969,635 lekë nga 236 subjekte.

Nga **6 masa disiplinore të rekomanduara**, nuk është zbatuar asnjë masë.

18.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të rikërkuara me shkresën nr. 950/7 prot., datë 18.12.2014, në zbatim të kërkesave ligjore. Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën 5,969,635 lekë duke bërë kërkesë padi në Gjykatë ndaj subjekteve debitorë.

Brenda Muajit Janar 2017

19.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ***në vitin 2015*** për plotësimin e nevojave me ushqime të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës, janë zhvilluar 5 tendera. Furnizimi me mallra ushqimore sipas kontratave dhe shtesave të kontratave, është në vlerën totale $(13,757,076+2,633,494)= 16,390,570$ lekë. Sipas inventarizimit, gjendja e mallrave ushqimore në magazinë në fillim të vitit është 1,250,988 lekë. Në total, hyrjet në magazinë të mallrave ushqimore plus gjendjen në fillim të vitit, janë $(16,390,570+1,250,988)= 17,641,558$ lekë.

Gjendja e mallrave ushqimore në fund të vitit 2015, ka rezultuar në vlerën 1,938,741 lekë.

Gjatë vitit 2015, janë bërë dalje nga magazina mallra ushqimore për kopshtet, çerdhet dhe konviktin e shkollës për vlerën totale $(17,641,558-1,938,741)= 15,702,817$ lekë.

Konsumi i mallrave ushqimore sipas normativave të miratuara dhe numrit të personave të trajtuar me ushqim, llogaritet në vlerën totale 10,794,779 lekë.

Në këtë rast, nuk është dokumentuar konsumi i mallrave ushqimore në vlerën $(15,702,817-10,794,779)= 4,908,038$ lekë.

19.1.Rekomandimi: Në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 1600 dhe nenit 25 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Dibër, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të auditoj më tej, gjetjet e konstatuara dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për shkeljet e konstatuara.

Brenda Muajit Shkurt 2017

B. MASAT PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronjat (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të udhëzimit Ministrisë të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 80,722,616 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia e Dibrës, janë administruar 7 kontrata për dhënien me qera të aseteve pyje kullota, objekte ndërtimore dhe troje publike. Nga këto, 5 kontrata janë lidhur nga ish Komunat, sot Njësi Administrative të Bashkisë Dibër dhe 2 të tjera janë lidhur nga ish Bashkia Peshkopi.

Për vitet 2014, 2015 dhe 2016, nuk janë paguar detyrimet kontraktuale nga subjekte qiramarrëse **për vlerën 9,402,678 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Dibër, respektivisht për subjektet: “██████████” shpk për vlerën 682,605 lekë, ██████████ për vlerën

220,800 lekë, "██████" sha për vlerën 900,000 lekë, "██████" shpk 5,799,273 lekë, "██████" sha për vlerën 900,000 lekë dhe "██████" sha për vlerën 900,000 lekë, në kundërshtim me kushtet e kontratës të lidhur midis palëve, ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për kodin Civil" i ndryshuar neni 850 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe cdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial".

1.1 Rekomandimi: Të merren masat dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **9,402,678 lekë** nga 7 subjekte qeramarrës, respektivisht: subjekti "██████" shpk për vlerën 682,605 lekë, F.M. për vlerën 220,800 lekë, "██████" sha për vlerën 900,000 lekë, "██████" shpk 5,799,273 lekë, "██████" sha për vlerën 900,000 lekë dhe "██████" sha për vlerën 900,000 lekë.

Brenda Muajt Mars 2017

2. Gjetje nga auditimi: Në 38 raste, lejet e shfrytëzimit u përkasin objekteve ndërtimore të ndërtuara në trojet publike, lejet e sheshit të cilave janë miratuar me vendime të KRRT-së të ish Bashkisë Peshkopi, në vitet 2003-2011. Sipërfaqja e përgjithshme e trojeve të dhëna për leje ndërtimi, është për 6428,8 m².

Për këto raste, janë lidhur me investitorin, kontratë qiradhënie për truallin dhe për rrjedhojë nuk është arkëtuar vlera e qerasë së truallit publik për shumën **58,710,570 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Dibër, mosveprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7980, datë 27.07.1995 "Për shitblerjen e trojeve" i ndryshuar neni 3, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën" i ndryshuar, nenet 30, 32, ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 13, VKM nr. 1712, datë 24.12.2008, Kreu III, pika 4, VKM nr. 529, datë 8.06.2011, Kreu III, pika 2 dhe VKM nr. 54, datë 5.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës të mënyrës së dhënies me qera, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore".

2.1. Rekomandimi: Të merren masat dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për shpërblimin e dëmit për vlerën **58,710,570 lekë** nga 38 subjekte të cilët kanë ndërtuar me leje ndërtimi, objekte mbi truallin publik dhe nuk kanë paguar vlerën e qerasë të truallit, sipas listës emërore të pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda Muajt Mars 2017

3. Gjetje nga auditimi: Për lejen zhvillimore ndërtimi nr.574, datë 15.05.2015 me objekt: "Ndërtim i Medresesë 4 kate", me investitor shoqatën "██████", nuk është llogaritur dhe arkëtuar detyrimi për taksën e lejes së ndërtimit në shumën **1,609,777 lekë të ardhura të munguara**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, neni 46.

3.1.Rekomandimi: Nga Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Dibër, ndaj investitorit Shoqata "██████" të **nxiret njoftim vlerësimi tatimore** për vlerën **1,609,777 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, **duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a.Ti dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b.Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar.

c.Në se nuk paguan detyrimet tatimore në afat, bazuar në neni 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamata vonesa (gjobë në masën 0,06% kamata vonesë të

detyrimin në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

Brenda Muajt Mars 2017

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Erebarë” ish-Komuna Maqellarë, Dibër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **2,527,086 lekë pa tvsh me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Dibër**, nga të cilat vlera 1,035,210 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 1,491,876 lekë si pasojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor ish-Komuna Maqellarë, Dibër dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Sh.Gj. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3 (trajtuar më hollësisht në faqet 92-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,527,086 lekë pa TVSH** për punime të pa kryera në fakt nga BOE “██████████” shpk & “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën datë 20.07.2015 me objekt: “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Erebarë” ish-Komuna Maqellarë, Dibër, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë së Qeverisjes Vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin: “Punime Sistemimi Asfaltimi Rrugë të Brendshme, Trotuare”, Bashkia Peshkopi, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan paguar më tepër në vlerën **2,272,227 lekë pa TVSH me dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Dibër**, për punime të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Peshkopi dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. G.I., neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 8.1, 8.3 dhe Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa për arkëtimin e vlerës **2,272,227 lekë pa TVSH** për punime të pa kryera nga OE “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 552, datë 13.05.2015 me objekt: “Punime Sistemimi Asfaltimi Rrugë të Brendshme, Trotuare” Bashkia Peshkopi, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të Njësisë së Qeverisjes Vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Gjetje nga Auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e fshatit Bllate e Poshtme dhe Bllate e Eper”, në ish-Komunën Maqellare viti 2014, me fond

limit 18,754,743 lekë, procedurë prokurimit “e hapur”, marrin pjesë 4 OE dhe s’kualifikuar 2 OE, fitues është shpallur BOE “████████” & “████████” me vlerë të ofertës 17,600,984 lekë pa tvsh. Nga auditimi u konstatua se KVO ka përdorur **dy standarte** në vlerësimin e kriterëve të kualifikim/pranimit, duke s’kualifikuar padrejtësisht nga gara OE me vlerë më të ulët, çka kanë sjellë impakt financiar negativ për Autoritetin Kontraktor **në vlerën 3,230,197 lekë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Dibër**, të llogaritur si diferencë ndërmjet ofertës më të lartë të shpallur fitues dhe ofertës më të ulët padrejtësisht të s’kualifikuar (BOE “████████” & “████████” me vlerë 17,600,984 lekë pa tvsh (-) minus ofertën e BOE “████████” & “████████” me vlerë 14,370,787 lekë pa tvsh). Konkretisht, ka s’kualifikuar BOE “████████” & “████████” dhe BOE “████████” & “████████” (ku nga auditimi u konstatua se këta OE i kanë plotësuar kërkesat e DST) për mangësi në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës, dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE me vlerë të lartë BOE “████████” shpk & “████████” me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST.

Veprime në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenet 52, 53 pika 1 dhe 4, 55 dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V pika 4.

6.1. Rekomandim: Bashkia Dibër, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **3,230,197 lekë** me nga **807,549 lekë secili** nga KVO e përbërë: **B.S.** me detyrë ish Specialist i Zyrës së Shërbimeve, **B.Gj.** me detyrë ish-Sekretar i këshillit të Bashkisë, **G.M.** me detyrë ish Specialist në Zyrën e Tatim Taksave dhe ish-titullari **AK ish-Komuna Maqellare z. B.A.** për kualifikim dhe shpalljen e padrejtë fitues të BOE “████████” & “████████”, me vlerë më të lartë.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Janë shpenzuar karburant për mjetet e transportit pa justifikuar me dokumentacionin e nevojshëm ligjor si fletëdaljet, fletudhëtimet etj. për sasinë 1,892.8 litra me vlerë **329,017 lekë me dëm ekonomik për buxhetin e Njësisë së Qeverisjes Lokale**, përkatësisht; (Nga ish- Komuna Tomin 352.8 litra me vlerë 57,753 lekë, ish -Komuna Sllovë 1280 litra me vlerë 223,984 lekë dhe ish- Komuna Luzni 260 litra me vlerë 46,280 lekë), veprime në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pikat 36, 37, 38 e 39, 42, 43, germa “a” e pikës 44, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

7.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar **shpërblimin e dëmit në vlerën 329,017 lekë**, nga personat përgjegjës

- z. **M.Z.** me detyrë ish-shofer në ish Komunën Tomin për vlerën **18,153 lekë**;
- z. **N.M.** me detyrë administrator në Njësinë Administrative Tomin, për vlerën **15,925 lekë**;
- z. **S.C.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Tomin për vlerën **22,150 lekë**,
- z. **Q.T.** specialist në ish Komunë Tomin, për vlerën **842 lekë**,
- z. **F.K.** specialist në ish Komunë Tomin, për vlerën **1,683 lekë**,
- z. **F.M.** me detyrë ish-Kryetar në ish- Komunën Sllovë për vlerën **111,993 lekë**,
- z. **D.K.** me detyrë Përgjegjës i Financës në ish Komunën Sllovë për vlerën **111,993 lekë**,
- z. **F.S.** me detyrë shofer në ish Komunën Luzni, për sasinë 130 litra naftë të pa argumentuar me vlerë **23,140 lekë** dhe
- z. **Sh.L.** me detyrë ish- Përgjegjës i Financës në ish- Komunën Luzni për sasinë 130 litrave naftë me vlerë **23,140 lekë**.

Brenda Muajt Shkurt 2017

8. Gjetje nga auditimi: Në një rast, Bashkia Dibër nuk ka marrë në dorëzim nga ish Komuna Sllovë, sot Njësi administrative, automjetin me vlerë kontabël 726,800 lekë.

Nga komisioni që u ngrit me kërkesë të grupit të auditimit të KLSH-së, u konstatua se ky mjet nuk gjendet në ambientet e kësaj Njësie.

Njësia Administrative Sllovë dhe Bashkia Dibër, nuk disponojnë kartelën inventariale për këtë automjet megjithëse është i regjistruar në llogaritë inventariale të Aktiveve të Qendrushme.

Vlera 726,800 lekë, mungesë e aktiveve të Bashkisë Dibër, **përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Dibër.

Nga titullari i Bashkisë, nuk janë marrë veprime ligjore në ngarkim të personave përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7.

8.1.Rekomandimi:

Bashkia Dibër, të marrë masat, duke ngritur një komision me specialistë të fushës, të identifikojë personat përgjegjës debitorë për mungesën e mjeteve të transportit duke ndjekur inventarizimet në vite deri në origjinën e krijimit të asetit.

Në mungesë të dokumentacionit kontabël ligjor, të merren masat dhe të kërkohet sipas procedurave ligjore, **arkëtimi i vlerës 726,800 lekë nga:**

-z. B.H. me detyrë ish Kryetari i Komunës Kala e Dodës.

-z. L.D. me detyrë ish Përgjegjës i Degës Financës aktualisht specialist i financës në Njësinë Administrative Kala e Dodës.

Brenda Muajt Shkurt 2017

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Dibër, gjatë viteve 2014 dhe 2015, janë paguar anëtarë të Këshillit të Bashkisë dhe të ish -Komunave edhe për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet në vlerën **1,579,392 lekë me dëm ekonomi për buxhetin e bashkisë Dibër**, nga të cilat për vitin 2014 në shumën 738,221 lekë dhe për 7/mujorin e vitit 2015 në shumën 841,111 lekë, në kundërshtim me nenin 29 pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.12.2000 “Për Qeverisjen Vendore” i ndryshuar.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër Dibër, të procedojë sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **1,579,392 lekë** nga ish anëtarët e Këshillit të ish -Bashkisë Peshkopi dhe të ish-Komunave sipas pasqyrave në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në 94 raste, nuk është llogaritur dhe ndalur sipas ligjit tatimi në burim i të ardhurave në masën 15%, për anëtarët e Këshillave të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Kryetarët e Fshatrave **për vlerën 149,412 lekë duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit**, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

10.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **149,412 lekë** nga ish anëtarët e Këshillave dhe ish -Kryetarë të fshatrave të ish-Komunave Tomin me 34 raste për vlerën 78,662 lekë, Luzni me 16 raste për vlerën 26,880 lekë, Zall- Dardhë me 21 raste për vlerën 19,530 lekë dhe Sllovë me 23 raste për vlerën 24,340 lekë sipas pasqyrave në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda Muajt Shkurt 2017

11. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzim nr. 54, datë 23.04.2015, janë paguar 8 punonjës për periudhën Janar-Mars 2015 me 20,000 lekë secili, gjithsej 160,000 lekë.

Për këto raste, nuk janë llogaritur dhe nuk janë ndalur sigurimet shoqërore për vlerën **43,520 lekë me dëm ekonomik**, për të ardhurat e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore,

kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 77, date 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

11.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dibër në bashkëpunim me Njësinë Administrative Sllovë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **43,520** lekë, nga punonjësit e Sektorit të Shërbimeve: z. *K.Ç.* për vlerën 5244, lekë, *F.Ç.* për vlerën 5,468 lekë, *Xh.Ç.* për vlerën 5,468 lekë, *B.Ç.* për 5,468 lekë, *Sh.S.* për vlerën 5,468 lekë, *K.Ç.* për vlerën 5,468 lekë, *L.S.* për vlerën 5,468 lekë, dhe *Gj.Ç.* për vlerën 5,468 lekë.

Brenda Muajt Shkurt 2017

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël në ish-Komunën Tomin, u konstatua se janë blerë pjesë këmbimi për automjetin, paguar me urdhër shpenzimi nr. 76, datë 18.05.2015 subjektit “██████████” Peshkopi në shumën **99,500 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e ish komunës Tomin, pasi:

Është faturë e thjeshtë tatimore nr. 7, datë 15.05.2015 me numër serie 535796, por nuk është bërë hyrje në magazinë, nuk ka akt marrje në dorëzim të mallrave.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III.

12.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **99,500 lekë**, nga anëtarët e komisionit të blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla; **D.K.** me detyrë ish Përgjegjëse e Financës Komuna Tomin, për vlerën **33,167** lekë; **M.D.** ish-anëtare për vlerën **33,167** lekë; z. **Q.T.** ish-anëtarë për vlerën **33,166** lekë.

Brenda Muajt Janar 2017

13.Gjetje nga auditimi: U konstatua se janë bërë shpenzime për udhëtime e dieta të punonjësve në kundërshtim me kërkesat ligjore në 6 raste për vlerën **17,450 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Njësisë së Qeverisjes Vendore, nga të cilat; në ish-Komunën Luzn për vlerën 12,500 lekë dhe në ish-Komunën Sllovë për vlerën 4,950 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, kapitulli i III-të, pika 1, 3, germa “b” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

13.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **17,450** lekë, nga personat përgjegjës: z. **Sh.L.** me detyrë ish Përgjegjës Financës në ish Komunën Luzni, për vlerën **5,000** lekë, z. **T.D.** me detyrë ish Drejtues në ish Komunën Luzni për vlerën **7,500** lekë, z. **R.M.** me detyrë specialist në ish-Komunën Sllovë, për vlerën 660 lekë, z. **F.M.** me detyrë ish Kryetar në ish -Komunën Sllovë, për vlerën 2,310, z. **M.L.** specialist në ish-Komunën Sllovë, për vlerën 660 lekë, z. **D.K.** me detyrë ish -Përgjegjës i Financës në ish-Komunën Sllovë, për vlerën 1,320 lekë.

Brenda Muajt Shkurt 2017

14.Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimi nr. 63, datë 21.05.2015, është paguar Sh. M., ish punonjës në Komunën Luzni për shumën **25,000 lekë me dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Dibër, pasi është paguar më tepër se sa detyrimi sipas vendimit Gjyqësor të formës së prerë.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga Sh.M. në vlerën **25,000 lekë**.

Brenda Muajt Shkurt 2017

C. MASA DISIPLINORE

c-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

-Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58 shkronja (c), **për 1 punonjës** sa vijon:

1. zj. Ç.O. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës aktualisht specialiste në sektorin e Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, pasi:

-Për furnizimet e kryera për punë/shërbime e mallra nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, dalë në zbatim të nenit 6, germa e, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, Kreu III-Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” sidomos në ish Komunën Slllovë, Tomin në Bashkinë Peshkopi .

-Gjatë viteve 2014-2015, ka lejuar që të paguhen 34 (15+19) anëtarë të Këshillit të Bashkisë pa marrë pjesë në mbledhje për shumën totale 525,074 lekë, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar, neni 29.

-Në shumicën e Njësive Administrative (ish Komuna) në përfundim të periudhës 07.07.2015, nuk janë kryer inventarizimet fizike.

- Edhe pse u konstatua se në Njësinë Administrative Kala e Dodës, mungon fizikisht mjeti i transportit me vlerë kontabël 726,800 lekë, ndërkohë që në pasqyrat financiare është regjistruar “gjendje”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i ndryshuar”.

c-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 9, pika 2, **i rekomandojmë** kryetarit të Bashkisë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për 3 punonjës:

a. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” për 2 punonjësit e mëposhtëm:

1-z. F.M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Strehimit për periudhën 01.12.2015 e në vazhdim pasi:

-Nuk ka marrë masat e nevojshme për mirë administrimin e pronave të Bashkisë, nuk ka të dhëna mbi pronat të regjistruara në ZVRPP në pronësi të ish Njesisë së Qeverisjes Vendore sot Njësi Administrative të Bashkisë Dibër,

Nuk disponon të dhëna të mjaftueshme mbi kontratat e lidhura nga njësia e qeverisjes vendore për dhënien me qera të pronave dhe arkëtimin e detyrimeve kontaktuale,

Nuk disponohen të dhëna mbi gjendjen e satusit juridik të këtyre pronave, nëse janë të dëmtuara, të zëna forcërisht nga persona të tretë, në se pronat e miratuara në pronësi, janë

marë në dorëzim me procesverbal të shoqëruara me hartat treguese sipas kërkesave ligjore etj.,

-Në administrimin e pyjeve dhe kullotave, mungojnë planet e mbarështrimit të pyllit komunal të miratuara nga këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore,

Mungon plani vjetor i shfrytëzimit, miratuar nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, i asetëve dhe nuk është aplikuar në ZVRPP Dibër për regjistrim e tyre në pronësi të Bashkisë Dibër.

Veprime dhe mosveprime në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1.2 dhe neni 27 pika 5, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar, **kap. III**, pika 20, 21, 22, 30 dhe pika 35/a, VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1, ligjit nr. 9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar neni 4, 5, 26, VKM nr. 22, datë 9.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të administrimit të pyllit komunal” pikat 4/d, 5 dhe 11, VKM nr. 396, datë 21.06.2006 “Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pikat 4, 5 si dhe ligjin nr. 49/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullosor” të ndryshuar, neni 14 pika 5 dhe neni 26.

2- L.Sh. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 19.08.2015 e në vazhdim pasi:

-Nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë Dibër, nuk janë krijuar regjistrat mbi evidentimin e taksës mbi tokën bujqësore, dhe taksën për ndërtesën, nuk janë marrë të dhënat e nevojshme nga Njësitë Administrative (ish komuna) dhe nga ZVRPP mbi pronësinë mbi tokën bujqësore dhe ndërtesat, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar nenet 20, 24 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

-Nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë Dibër, nuk është nxjerë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të MF nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

-Për arkëtimin e detyrimeve nga bizneset debitorë, nuk u janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 90, 93.

-Nuk është llogaritur dhe arkëtuar penalitet ndaj bizneseve debitorë, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, neni 114.

b“Vërejtje” për 1 punonjës si më poshtë:

1-Xh.K. me detyrë Kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën 20.09.2015 e në vazhdim :

Aktiviteti i Policisë Bashkiake nuk është bërë mbi bazën e programeve mujore dhe vjetore të miratuara nga Titullari i Bashkisë, praktikë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës" i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme “TIP” të Policisë Bashkiake dhe Komunës miratuar

me Urdhërin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendorë dhe Ministrisë së Rendit Publik nr.1, datë 17.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës”.

c-III. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Dibër (Sektor i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D1. Masa Administrative për Agjencinë e Prokurimit Publik

d:1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenit 4, 12, 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 2 datë 10.06.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës përkatëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 12 ish punonjësve si më poshtë:**

1-Në 5 tenderët me objekt: **“Blerje mallra ushqimore për nevojat e institucionit, kopshteve, çerdheve”**, me fondin limit total 12,618,533 lekë, konkretisht në tenderin: “Blerje mish viçi“ me urdhër prokurimi nr. 15, datë 02.03.2015, fondi limit 1,945,750 lekë, “Blerje bukë“ me urdhër prokurimi nr. 15, datë 02.03.2015, fondi limit 1,440,000 lekë, “Blerje bulmet“ me urdhër prokurimi nr. 17, datë 02.03.2015, fondi limit 2,059,500 lekë, “Blerje fruta“ me urdhër prokurimi nr. 18, datë 02.03.2015, fondi limit 1.766.346 lekë dhe “Blerje ushqime“ me urdhër prokurimi nr. 19, datë 02.03.2015, fondi limit 5,406,937 lekë.

a. Njësia e Prokurimit

1. **A.B.** me detyrë ish jurist.
2. **A.B.** me detyrë ish specialist i Urbanistikës.
3. **P.U.** me detyrë ish specialist e finances.

Nga njësia e prokurimit publik, nuk është përlllogaritur dhe nuk është dokumentuar vlera e fondit limit të prokuruar, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik“.

Në këtë rast, është bërë ndarja, e vlerës së kontratës në 5 procedura tenderi për të njëjtën natyrë të mallrave të prokuruar, në kundërshtim me kërkesat e nenit 12, pika 2, germa c, ç, dhe d të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Për shkak sa më sipër, është konstatuar dëm ekonomik **për vlerën 4,908,038 lekë**.

2- Në tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e fshatit Bllatë e Poshtme dhe Bllatë e Epër”, me urdhër prokurimi nr. 5, datë 13.10.2014, fondi limit 18,754,743 lekë.

a. Njësia e Prokurimit.

- 1. B.L.** me detyrë ish-specialist Zyrës së Tatim Taksave.
- 2. M.Sh.** me detyrë ish-arkivist.
- 3. Sh.Xh.** me detyrë ish specialist e Zyrës së Financës.

U konstatuan mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike të favorshme, nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë objektive dhe përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderit. Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk janë të argumentuara me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve

Konkretisht:

a- në seksionin 2 pika. 2, nënpika (f), nuk argumentohet kërkesa për fuqinë punëtore mesatarisht jo më pak se 52 punonjës për periudhën janar 2014-shtator 2014.

b- në seksionin 2 pika. 2, nënpika (g) për “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike”, nuk argumentohet pse janë kërkuar: - 4 copë Mjete Gjermimi; - 1 Fabrikë Asfaltbetoni; - Fabrikë Betoni; - 2 copë rrula për ngjeshje toke; - 2 copë rrula ngjeshje asfalti.

c- nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 379, datë 11.06.2014 pasi nuk është kërkuar “Vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike”,

Sa më sipër, NJHDT ka vepruar në kundërshtim me pikat (1) dhe (3) të nenit 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Hartimi i Dokumenteve të tenderit”, në të cilin thuhet: “Për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në LPP dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës”,

b. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO)

7. B.S. me detyrë ish Specialist i Zyrës së Shërbimeve.

8. B.Gj. me detyrë ish Sekretar i këshillit të Bashkisë.

9. G.M. me detyrë ish Specialist në Zyrën e Tatim Taksave.

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues **BOE: [REDAKTUAR] & [REDAKTUAR]**, në kundërshtim me LPP, RRPP dhe DST, pasi OE “[REDAKTUAR]” nuk ka plotësuar kërkesën e AK në kriteret e veçanta të kualifikimit në paragrafin “Shënim”, ku përcaktohet se: “Në rast se nyja e thyerjes, fabrika e betonit, dhe fabrika e prodhimit të asfaltbetonit nuk është në pronësi apo me qira ofertuesi duhet të ketë aktmarrëveshje noteriale specifike me furnizuesin për objektin e prokurimit të lartpërmendur ku të pasqyrohet sasia, cilësia, çmimi, periudha e furnizimit si dhe penalitetet në rast të mosrespektimit të kushteve të aktmarrëveshjes. Bashkëlidhur të paraqitet certifikata ISO 9001:2008 për prodhuesin e betonit, asfaltbetonit dhe inerteve të kontraktuar”, pasi në aktmarrëveshjen datë 24.04.2014 certifikata e cilësisë ISO 9001:2008 për prodhuesin e betonit, asfaltbetonit dhe inerteve nuk është në gjuhën e ofertës.

Sa më sipër, në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga e fshatit Bllatë e Poshtme dhe Bllatë e Epër”, në ish-Komunën Maqellare viti 2014, me fond limit

18,754,743 lekë, procedurë prokurimit “e hapur”, marrin pjesë 4 OE dhe s`kualifikuar 2 OE, fitues është shpallur BOE “ [REDACTED] ” me vlerë të ofertës 17,600,984 lekë pa tvsh. Nga auditimi u konstatua se KVO ka përdorur **dy standarte** në vlerësimin e kriterëve të kualifikim/pranimin, duke s`kualifikuar padrejtësisht nga gara OE me vlerë më të ulët, çka kanë sjellë impakt financiar negativ për Autoritetin Kontraktor **në vlerën 3,230,197 lekë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Dibër**, të llogaritur si diferencë ndërmjet ofertës më të lartë të shpallur fitues dhe ofertës më të ulët padrejtësisht të s`kualifikuar (BOE “[REDACTED]” & “[REDACTED]” me vlerë 17,600,984 lekë pa tvsh (-) minus ofertën e BOE “[REDACTED]” & “[REDACTED]” me vlerë 14,370,787 lekë pa tvsh). Konkretisht, ka s`kualifikuar BOE “[REDACTED]” & “[REDACTED]” dhe BOE “[REDACTED]” & “[REDACTED]” (ku nga auditimi u konstatua se këta OE i kanë plotësuar kërkesat e DST) për mangësi në plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, të cilat lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës, dhe ka kualifikuar e shpallur fitues OE me vlerë të lartë BOE “[REDACTED]” & “[REDACTED]” me mangësi ë plotësimin e kriterëve të DST.

Veprime në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenet 52, 53 pika 1 dhe 4, 55 dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V pika 4.

3- Në tenderin me objekt: “Ndërtim 4 terrene sportive në shkollat “Nazmi Rushiti”, “Demir Gashi”, “Selim Alliu”, “Seit Nejdani”, urdhër prokurimi nr. 15, datë 20,10,2014, fondi limit 26,050,991 lekë.

a.Njësia e Prokurimit

10. A.B. me detyrë jurist.

11. A.B. me detyrë ish specialist i Zyrës së Urbanistikës.

12. P.U. me detyrë specialist i Zyrës së Financës.

Në përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, u konstatuan mangësi, pasi nuk janë në përputhje nenin 46, pika 1, e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, për arsye se: nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë objektive dhe përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në dokumentet e tenderit. Konkretisht si më poshtë:

1- Është kërkuar që “Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë Liçenzën Profesionale të shoqërisë duke dëshmuar se zotëron këto kategori lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: NP1-B, NP2-B, NP11-B, NP12-B, NS8-B, NS9-B, NS10-B, NS18-B, ku konstatohet se të janë të tepruara dhe të paargumentuara me volume punë, pasi kategoritë e nivelit (B) pasi parashikojnë punime në vlerë nga 21 milion lekë - 400 milion lekë, në një kohë që fondi limit është 25,978,672 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2- Kërkohet certifikata ISO 39001-2012 për (sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor), kërkesë që nuk ka lidhje me objektin e kontratës pasi duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 46, pika 1 të LPP, i ndryshuar.

3- Është kërkuar një punësim mesatar prej 25 punonjësish për përudhen Janar 2012-Korrik 2014, në një kohë që nuk ka argumentim nga NJHDT për numrin e punonjësve të kërkuar në krahasim me volumet e punimeve.

4- Në listë pagesa operatori të ketë 5 punonjës elektrike të pajisur me dëshmi kualifikimi, si kërkesë sigurie në lidhje me zbatimin e standardeve teknike. Të ketë të punësuar 2 manovratorë makinerish me dëshmi aftësie dhe dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, kërkesë kjo e tejkualuar dhe e paargumentuar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat

prokurimit publik”, pasi nuk justifikohet me volumet e punimeve në raport edhe me afatin kryerjes së punimeve.

5- Kërkesa “Operatori ekonomik preferohet të ketë punime të ngjashme me të njëjtin objekt (terrene sportive)”, është një kriter i tejkaluar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu III, pika 3, nënpika (a), në të kërkohet për punë të ‘ngjashme’ dhe jo të ‘njëjta’. Kriter i përdorur nga KVO për përjashtimin e operatorëve me ofertë me të ulet.

6- Kërkesa për Inxhinier Mekanik, është kërkuar padrejtësisht pasi nuk është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe në preventivin e miratuar nuk ka asnjë zë në të cilin të parashikohet punë për inxhinier mekanik.

Sa më sipër, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe neni 20, “Mos diskriminimi”, në të cilën kërkohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tjera”, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2 “Hartimi i Dokumenteve të tenderit”, në të cilin thuhet: “Për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në LPP dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës”.

D2. Masa Administrative për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor

1. Nga Bashkia Dibër, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, **t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vendosë masë administrative **me gjobë në masën 500,000 lekë për Ing. Sh.Gj.** në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

-Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Erebarë”, ish-Komuna Maqellarë Dibër, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore **në vlerën 2,527,086 lekë pa tvsh, nga të cilat vlera 1,035,210 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 1,491,876 lekë si pasojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Bllate e Poshtme dhe Bllate e Epër”, ish-Komuna Maqellarë, Dibër, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore **në vlerën 4,157,640 lekë pa tvsh, nga të cilat vlera 1,395,792 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 2,761,848 lekë si pasojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me ndryshimin përkatës.** Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

2. Nga Bashkia Dibër, të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, **t’i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vendosë masë administrative **me gjobë në masën 200,000 lekë për Ing. G.I.** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në zbatimin e kontratës me objekt “Punime Sistemimi Asfaltimi Rrugë të Brendshme, Trotuare”, Bashkia Peshkopi, nga mos kontrolli i punës së kryer, ka raportuar, situacionuar

dhe likujduar për punime të pakryera në vlerën **2,272,227 lekë pa tvsh**, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Menjëherë

E. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për:

1- B.S. me detyrë ish Specialist i Zyrës së Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish-Komunën Maqellare;

2- B.Gj. me detyrë ish-Sekretar i këshillit të Komunës, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish-Komunën Maqellare;

3- G.M. me detyrë ish Specialist në Zyrën e Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish-Komunën Maqellare;

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, si dhe në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenet 52, 53 pika 1 dhe 4, 55 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu V pika 4.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R